



REPUBLIKA E SHQIPERISË



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**  
**SENATI AKADEMIK**

Nr. 547/2 Prot.

Tiranë, më 06/03 /2023

**VENDIM**

**Nr. 03, datë 06.03.2023**

**PËR**

**MIRATIMIN E RAPORTIT PËR REALIZIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2022 DHE  
PROJEKT-BUXHETIN E VITIT 2023**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, pika 1, gërma h, Statutin e UPT-së, neni 9, pika 3, gërma d, me propozimin e Administratorit të Institucionit, Senati Akademik në mbledhjen e datës 06.03.2023,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë raportin financiar për realizimin e buxhetit të vitit 2022.
2. Të miratojë paraprakisht projekt-buxhetin e hartuar nga Administratori për vitin 2023.
3. T’i propozojë Bordit të Administrimit miratimin e raportit financiar për realizimin e buxhetit të vitit 2022 dhe projekt-buxhetin për vitin 2023 sipas materialit dhe relacionit bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

**Prof. Dr. Andrea Maligari**

